Breaking News: Karmëz/Finalizohet operacioni i koduar "The last one"

Komunikata

25/03/2026

Raporti I Ngjarjeve, 25 Mars 2026

Raporti i ngjarjeve, 25 mars 2026

Maliq/Finalizohet operacioni policor i koduar "Sovjani".

Qarkullonte me automjet i armatosur me armë zjarri automatik dhe posedonte në banesë armë gjahu pa leje, kapet dhe vihet në pranga 30-vjeçari.

Sekuestrohen një armë zjarri automatik, një armë gjahu teke, municion dhe një automjet.

Në vijim të punës për sigurimin e informacioneve dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, shërbimet e Komisariatit të Policisë Maliq, bazuar në informacionet e siguruara se një shtetas qarkullonte i armatosur, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Sovjani".

Si rezultat i operacionit, në fshatin Sovjan, Maliq, shërbimet e Policisë konstatuan në një rrugë mes parcelave bujqësore një automjet, në të cilin dyshohej se udhëtonte shtetasi i armatosur, dhe e ndaluan për kontroll.

Gjatë kontrollit në automjet, shërbimet e Policisë gjetën 1 armë zjarri tip automatik.

Gjithashtu, gjatë kontrollit në banesën e tij, u gjetën një armë gjahu teke dhe një masi e vogël municioni luftarak.

Sendet e jashtëligjshme, së bashku me automjetin, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve procedurale, u arrestua në flagrancë shtetasi B. B., 30 vjeç, banues në fshatin Sovjan, Maliq, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive".

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Korçës, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Gjirokastër referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin I. Xh., 60 vjeç, banues në Gjirokastër, pasi dyshohet se ka goditur me gur shtetasen L. S., për motive të dobëta.

Specialistët e Sektorit të Policisë Rrugore referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin M. D., 46 vjeç, banues në fshatin Tranoshisht, Gjirokastër, pasi u konstatua në aksin rrugor "Sofratikë-Libohovë", duke drejtuar automjetin, në efektin e alkoolit.

Gjithashtu, kërta specialistët referuan materialet në Prokurori, për vlerësim, pasi në aksin rrugor "Gusmar-Nivicë", shtetasi S. P, 37 vjeç, banues në Dibër, dyshohet se ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe si pasojë automjeti ka dalë nga truga. Nga aksidenti është dëmtuar 37-vjeçari, i cili po merr mjekim në spital dhe është jashtë rrezikut për jetën.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme.

DVKM Kukës

Kapen nga Policia Kufitare e Morinës, 3 shtetas të shpallur në kërkim ndërkombëtar/kombëtar.

Strukturat e Policisë Kufitare Morinë, në vijim të kontrolleve dhe verifikimeve në hyrje/dalje, me objektiva goditjen e paligjshmërive në kufi, si dhe ndalimin e shtetasve të shpallur në kërkim, të cilët tentojnë të lëvizin ilegalisht për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, organizuan punën në bashkëpunim me strukturat e DVP Kukës dhe si rezultat, në hyrje të RSh-së, kapën dhe arrestuan/ndaluan 3 shtetas, konkretisht:

-U kap dhe u arrestua me qëllim ekstradimin në Gjermani, shtetasi M. G., 65 vjeç, banues në Kosovë Nga verifikimet e kryera dhe nga informacioni i shkëmbyer me Interpol Tiranën, rezultoi se ky shtetas ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Wiesbaden, Gjermani, pasi Gjykata e Frankfurtit e ka dënuar me 4 vjet e 1 muaj burgim, për veprat penale "Vjedhja" , "Grupi kriminal" dhe "Organizata kriminale". Nga dënimi i i kanë mbetur për të kryer 18 muaj.

-- U kap dhe u arrestua me qëllim ekstradimin në Kuvajt, shtetasi Xh. S., 47 vjeç, banues në Prishtinë. Nga verifikimet e kryera dhe nga informacioni i shkëmbyer me Interpol Tiranën, rezultoi se ky shtetas ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet në Kuvajt, për veprën penale "Vjedhja e rëndë".

Interpol Tirana, në bashkëpunim me homologët, vijoné procedurat për ekstradimin e këtyre 2 shtetasve.

-U kap shtetasi R. P., 36 vjeç, banues në Kosovë, pasi nga verifikimet rezultoi se ishte shpallur në kërkim kombëtar, pasi Gjykata e Tiranës e ka dënuar me 4 vjet burgim, për veprën penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve".

Veprimet e tjera procedurale me këtë shtetas do të kryhen nga DVP Tiranë.

DVP Kukës

Specialistët e qarkullimit rrugor të DVP Kukës arrestuan në flagrancë shtetasin A. Sh., 45 vjeç, banues në Kukës, për veprat penale "Shkelja e regullave të qarkullimit rrugor" dhe "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të fholta", pasi u konstatua në qytetin e Kukësit, duke drejtuar në gjendje të dehur, automjetin, në sensin e kundërt të lëvizjes.

Nga kontrolli i ushtruar në automjet, u gjet një armë e fholtë (thikë), e cila u sekuestrua si cilësinë e provës materiale, bashkë me automjetin.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Has arrestuan në flagrancë shtetasin I. C., 61 vjeç, banues në Has, pasi ka kallëzuar bashkëshortja e tij 57 vjeçe, se ai ka ushtruar dhunë ndaj saj. 57-vjeçarja u pajis me urdhër mbrojtjeje.

Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin B. Rr., 48, vjeç, banues në Tropojë, pasi ka kallëzuar ish-bashkëshortja e tij 48 vjeçe, se ai ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj saj. 48-vjeçarja u pajis me urdhër mbrojtjeje.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Kukës referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin A. M., 37 vjeç, pasi është konstatuar duke kyer punime ndërtimi afër një shkolle, pa leje nga organet kompetente.

Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori, ku filloi procedimi penal për shtetasin S. D., pasi ka kallëzuar shtetasja A . D., se ai e ka goditur dhe e ka kanosur, për motive të dobëta.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Reagim i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë

Në lidhje me një video të publikuar në rrjetet sociale, në të cilën shfaqet një punonjës i Policisë Rrugore, i dyshuar për marrje ryshfeti nga një drejtues automjeti, ju informojmë se:

Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë ka marrë menjëherë masën e pezullimit nga detyra dhe ka nisur procedimin disiplinor për shkelje të rëndë ndaj inspektorit K. P., me detyrë trup shëbërimi në Seksionin e Trafikut Urban dhe Interurban, pranë DVP Vlorë.

Paralelisht, në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore ka nisur hetimin penal ndaj punonjësit të përfshirë.

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë falënderon median dhe qytetarët për bashkëpunimin dhe denoncimin e rasteve të abuzimit me detyrën, duke i inkurajuar të vijojnë të denoncojnë çdo rast të paligjshmërisë, me garancinë e një reagimi të shpejtë, të paanshëm dhe në përputhje me ligjin.

Drejtoria Vendore e Policisë Dibër

Dhunoi fizikisht bashkëshorten, arrestohet në flagrancë 60-vjeçari.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Mat arrestuan në flagrancë shtetasin P. R., 60 vjeç, banues në Ulëz, pasi në banesë ka ushtruar dhunë fizike ndaj bashkëshortes së tij.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Bulqizë referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. S., 69 vjeç, banues në fshatin Zall-Dritkaçan, i cili dyshohet se ka ndezur zjarr në një sipërfaqe toke, me qëllim djegjen dhe pastrimin e saj nga barishtet.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë Dibër, për veprime të mëtejshme.

--

Mat / Informacion paraprak

Rreth orës 09.40, shtetasi I.D., 69 vjeç, banues në fshatin Dorn, njësia administrative Gurë, Klos, dyshohet se, duke prerë dru zjarri në një terren malor, ka mbshqitur dhe për pasojë, ka humbur jetën.

Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të këtij rasti.

Kavajë/Zbardhen 4 raste të vjedhjes në banesa, kapet dhe vihet në pranga autori i dyshuar, me precedent për vjedhje.

31-vjeçari i kreu 3 nga vjedhjet ndërkohë që ishte në kërkim për një vjedhje me dhunë të kryer në Tiranë.

Si rezultat i punës intensive hetimore që kryhet për zbardhjen e vjedhjeve, identifikimin dhe kapjen e autorëve, shërbimet e Komisariatit të Policisë Durrës, bazuar dhe në informacione të siguruara në mugë operative, zbardhën disa vjedhje të kryera gjatë dy muajve të fundit dhe identifikuan autorin e dyshuar, shtetasin:

-T. H., 31 vjeç, banues në Skrapar.

Nga hetimet dyshohet se ky shtetas, gjatë muajve shkurt dhe mars 2026, ka vjedhur orendi, pajisje dhe sende me vlerë, në 4 banesa, në Golem dhe Kavajë.

Nga verifikimet rezultoi se ky shtetas ishte shpallur në kërkim nga Komisariati i Policisë Nr. 4, Tiranë, për veprën penale "Vjedhja me dhunë", kryer në bashkëpunim, pasi dyshohet se më datë 17.03.2026, në bashkëpunim me një tjetër shtetas, i ka vjedhur me dhunë një 28-vjeçari, 2 celularë dhe një shumë parash.

Veprimet procedurale për ndalimin e këtij shtetasi u kryen nga strukturat e DVP Tiranë.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Durrësit, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Vjedhja", kryer më shumë se një herë.

Drejtoria Vendore e Policisë Fier

Specialistët e qarkullimit rrugor të DVP Fier arrestuan shtetasin H. E.(S)., 37 vjeç, banues në Fier, pasi u kap duke drejtuar automjetin, në gjendje të dehur.

Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:

-T. M., 56 vjeç, banues në fshatin Sulaj, pasi duke drejtuar motorsipetin, dyshohet se ka humbur kontrollin dhe si pasojë motorsipeti ka dalë nga truga. Nga aksidenti është dëmtuar shtetasi T. M., i cili po merr mjekim në spital dhe është jashtë rrezikut për jetën;

-M. V., 71 vjeç, banues në fshatin Krutje e Poshtme, pasi u kap duke drejtuar pa leje drejtimi, një motorsipet pa targë;

-një 16-vjeçar, pasi duke drejtuar pa leje drejtimi, një motorsipet pa targë, ka humbur kontrollin dhe si pasojë motorsipeti është përplasur me automjetin me drejtues shtetasin M. Ll., 52 vjeç. Nga aksidenti është dëmtuar lehtë shtetasi i mitur.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare të DVP Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin F. Sh., 61 vjeç, banues në Kavajë, pasi nga kontrolli në automjetin që ai drejtonte, në aksin rrugor "Levan-Tepelenë", u konstatua se transportonte rreth 30 ton drithë (misër), pa faturë.

Në stacionin e Policisë Patos kallëzoi shtetasja B. B., 59 vjeçe, banuese në Patos, se është larguar nga banesa, djali i saj, shtetasi J. B., 31 vjeç. Po punohet për gjetjen e tij.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve arrestuan një shtetas të mitur, 17 vjeç, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" i gjetën saxi të dyshuara lëndë narkotike Kokainë dhe Heroinë, të cilat u sekuestruan si provë materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. A., pasi dyshohet se i ka marrë një shumë parash shtetasit E. S., dhe nuk ia ka kthyer ende.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin G. J., pasi dyshohet se ka marrë një shumë parash shtetasit M. N.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. S., pasi dyshohet se në ané të mashtrimit nuk i ka kryer një pagesë që i detyrohej shtetasit P. B.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3:

-ndaluan shtetasen I. K., 35 vjeçe, pasi u konstatuan shkelje të masës së sigurisë "Arrest në shtëpi";

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin K. M., pasi dyshohet se, për motive të dobëta, është konflikturar me shtetasin A. B.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasit:

-L. T., pasi dyshohet se ka kanosur motrën e tij përmes celularit;

-M. V., pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj ish-të dashurës së tij.

Punohet për kapjen e tyre dhe sqarimin e rrethanave të rasteve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për dy shtetasa të mitur, pasi dyshohet se kanë dëmtuar godinën e një subjekti.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6:

-arrestuan shtetasin D. T., 38 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëjetueses së tij;

-referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin P. S., pasi dyshohet se ka përndjekur ish-të dashurën.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Krujë:

-arrestuan shtetasin Gj. C., 63 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj mbesës së tij;

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen D. T., pasi dyshohet se për arsye pronësie ka kanosur shtetasen S. T.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor arrestuan shtetasin S. H., 37 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjetin në gjendje të dehur.

Gjithashtu, referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasit:

-T. M., 56 vjeç, banues në fshatin Sulaj, pasi duke drejtuar motorsipetin, dyshohet se ka humbur kontrollin dhe si pasojë motorsipeti ka dalë nga truga. Nga aksidenti është dëmtuar shtetasi T. M., i cili po merr mjekim në spital dhe është jashtë rrezikut për jetën;

-M. V., 71 vjeç, banues në fshatin Krutje e Poshtme, pasi u kap duke drejtuar pa leje drejtimi, një motorsipet pa targë;

-një 16-vjeçar, pasi duke drejtuar pa leje drejtimi, një motorsipet pa targë, ka humbur kontrollin dhe si pasojë motorsipeti është përplasur me automjetin me drejtues shtetasin M. Ll., 52 vjeç. Nga aksidenti është dëmtuar lehtë shtetasi i mitur.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare të DVP Fier referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin F. Sh., 61 vjeç, banues në Kavajë, pasi nga kontrolli në automjetin që ai drejtonte, në aksin rrugor "Levan-Tepelenë", u konstatua se transportonte rreth 30 ton drithë (misër), pa faturë.

Në stacionin e Policisë Patos kallëzoi shtetasja B. B., 59 vjeçe, banuese në Patos, se është larguar nga banesa, djali i saj, shtetasi J. B., 31 vjeç. Po punohet për gjetjen e tij.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme.

Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve arrestuan një shtetas të mitur, 17 vjeç, pasi gjatë kontrollit fizik, shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" i gjetën saxi të dyshuara lëndë narkotike Kokainë dhe Heroinë, të cilat u sekuestruan si provë materiale.

Specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomiko-Financiare referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. A., pasi dyshohet se i ka marrë një shumë parash shtetasit E. S., dhe nuk ia ka kthyer ende.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 1 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin G. J., pasi dyshohet se ka marrë një shumë parash shtetasit M. N.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin A. S., pasi dyshohet se në ané të mashtrimit nuk i ka kryer një pagesë që i detyrohej shtetasit P. B.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 3:

-ndaluan shtetasen I. K., 35 vjeçe, pasi u konstatuan shkelje të masës së sigurisë "Arrest në shtëpi";

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin K. M., pasi dyshohet se, për motive të dobëta, është konflikturar me shtetasin A. B.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 4 referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasit:

-L. T., pasi dyshohet se ka kanosur motrën e tij përmes celularit;

-M. V., pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj ish-të dashurës së tij.

Punohet për kapjen e tyre dhe sqarimin e rrethanave të rasteve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 5 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për dy shtetasa të mitur, pasi dyshohet se kanë dëmtuar godinën e një subjekti.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 6:

-arrestuan shtetasin D. T., 38 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj bashkëjetueses së tij;

-referuan materialet në Prokurori dhe shpallën në kërkim shtetasin P. S., pasi dyshohet se ka përndjekur ish-të dashurën.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Krujë:

-arrestuan shtetasin Gj. C., 63 vjeç, pasi dyshohet se ka ushtruar dhunë ndaj mbesës së tij;

-referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasen D. T., pasi dyshohet se për arsye pronësie ka kanosur shtetasen S. T.

Specialistët e Qarkullimit Rrugor arrestuan shtetasin S. H., 37 vjeç, pasi u kap duke drejtuar automjetin në gjendje të dehur.

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent